



BPrAL AAB
INSTITUCIONI I ARSIMIT UNIVERSITAR

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

RESURSET NJERËZORE GJATË PROCESIT TË MENAXHIMIT TË PROJEKTIT

LËNDA: MENAXHIMI I PROJEKTËVE TË TI-së

Ligjërues: MSc. Artan DRESHAJ

HYRJE

- ▶ Elementet kryesore për menaxhimin e projektëve të TI-së janë njerëzit, proceset, dhe teknologjia.
- ▶ Teknologjia është një mjet, ndërsa proceset sigurojnë një strukturë dhe rrugë për menaxhimin dhe zbatimin e projektit.
- ▶ Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është komponentë themelore për përcaktimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së projektit.
- ▶ Sipas udhëzuesit PMBOK, Projekti i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore përfshin proceset që organizojnë, drejtojnë, dhe udhëheqin ekipin e projektit.
- ▶ Ekipi i projektit është i përbërë prej njerëzve me role dhe përgjegjësi të caktuara për përfundimin e projektit.

ORGANIZIMI DHE PLANIFIKIMI I PROJEKTIT

- ▶ Performanca e një organizate apo një projekti vlerësohet kryesisht nga ajo se sa mirë janë organizuar burimet (resurset) e saj.
- ▶ Në përgjithësi, strukturat janë krijuar brenda një organizate për të menaxhuar më burimet e brendshme (inputet), përpunuar dhe për të nxjerrë produktin nga ato burime. Për shembull, departamentet bazohen në aftësitë e specializuara të nevojshme për të menaxhuar një burim të veçantë të krijuar - sistemet informative menaxhohen nga ekspertet e fushës së TI-së.
- ▶ Megjithatë, struktura e një organizate duhet ti përshtatet strategjisë së saj, dhe organizatat mund të ndjekin strategji të ndryshme, ka kuptim se asnjë strukturë e vetme, nuk mund të punojë mirë për çdo organizatë.
- ▶ Projektet janë pjesë e një organizate dhe mund të mendohen si mikro organizata që kërkojnë burime, procese, dhe strukturë.

ORGANIZIMI DHE PLANIFIKIMI I PROJEKTIT -

Organizimi formal

- ▶ **Organizimi funksional** - Struktura funksionale organizative mund të mendohet si forma më tradicionale e organizimit.
- ▶ Kjo strukturë e veçantë është e bazuar mbi organizimin e burimeve për të kryer detyra apo veprimtari të specializuara për të arritur qëllimet e organizatës.
- ▶ Projektet menaxhohen në kuadër të hierarkisë ekzistuese funksionale.
- ▶ Në rastin e një projekti të teknologjisë së informacionit, njohurit dhe ekspertiza për të hartuar dhe zhvilluar një aplikacion janë pjesë e nën-njësive të sistemeve të informacionit, ndërsa domain ose njohurit funksionale gjinden në një prej reparteve funksionale.
- ▶ Si rezultat, ekipi i projektit mund të përbëhet nga individë nga dy apo më shumë zona funksionale.
- ▶ Ekziston një numër i avantazheve për projektet që sponsorizohen nga organizatat me strukturat funksionale.
 - ▶ Rritja e fleksibilitetit.
 - ▶ Gjerësia dhe thellësia e njohurive dhe eksperiencës.
 - ▶ Më pak dyfishime.

ORGANIZIMI DHE PLANIFIKIMI I PROJEKTIT - Organizimi formal - (2)




Figure 4.2 Functional Organizational Structure

ORGANIZIMI DHE PLANIFIKIMI I PROJEKTIT -

Organizimi formal - (3)

- ▶ Përveç përparësive tek organizimi funksional, më rastin e menaxhimit të projekteve, ekzistojnë edhe shumë mangësi, ku përfshihen:
 - ▶ Përcaktimi i autoritetit dhe përgjegjësisë,
 - ▶ Vonesa në kthim të përgjigjeve,
 - ▶ Integrim i dobët.

ORGANIZIMI DHE PLANIFIKIMI I PROJEKTIT -

Organizimi formal - (4)

- ▶ **Organizimi bazuar në projekte** - kjo strukturë organizative mbështet projektet si forma dominuese e biznesit.
- ▶ Një organizim i bazuar në projekte do të mbështesë projekte të shumta në një kohë dhe do të integroj mjetet dhe teknikat e menaxhimit të projektit në të gjithë organizatën.
- ▶ Çdo projekt është trajtuar si një njësi e veçantë dhe relativisht e pavarur brenda organizatës.
- ▶ Menaxheri i projektit është autoriteti dhe përgjegjësi i vetëm për projektin dhe burimet e tij, ndërsa organizata mbështetëse siguron kontrole financiare dhe administrative.
- ▶ Si menaxheri i projektit dhe ekipi i projektit janë të përcaktuar në mënyrë tipike për një projekt me kohë të plotë.

ORGANIZIMI DHE PLANIFIKIMI I PROJEKTIT - Organizimi formal - (5)

- ▶ Edhe tek kjo formë e organizimit ekzistojnë përparësitë dhe mangësitë.
- ▶ Përparësitë përfshijnë:
 - ▶ Autoritet dhe përgjegjësi të qarta,
 - ▶ Përmirësimi i komunikimit,
 - ▶ Niveli i lartë i integritimit.
- ▶ Mangësitë përfshijnë:
 - ▶ Izolimi i projektit,
 - ▶ Dyfishimi i përpjekjeve - burimeve




Figure 4.3 The Project Organization

ORGANIZIMI DHE PLANIFIKIMI I PROJEKTIT - Organizimi formal - (6)

- *Organizimi matricë* - është një kombinim i strukturës vertikale funksionale dhe strukture horizontale të projektit.




Figure 4.4 Matrix Organization

ORGANIZIMI DHE PLANIFIKIMI I PROJEKTIT -

Organizimi joformal

- ▶ Organizimi formal është strukturë publike që përcakton linjat zyrtare të autoritetit, përgjegjësisë, dhe të raportimit.
- ▶ Përderisa struktura formale na tregon se si individët ose grupet brenda një organizate duhet të lidhen dhe funksionojnë me njëri-tjetrin, kjo nuk do të na tregojë se si ata në realitet e bëjnë atë.
- ▶ Në shumë raste organizimi joformal anashkalon linjat formale të komunikimit dhe autoritetit për shkak të marrëdhënieve të pashmangshme pozitive dhe negative që ndodhin me kalimin e kohës në çdo organizatë.
- ▶ Fuqia në një organizatë, nuk është e përcaktuar vetëm nga vendosja e njeriut në hierarki, mirëpo edhe se sa mirë është i lidhur në rrjetin joformal.
- ▶ Shkalla e lidhjes së një personi në organizim joformal përcakton se çfarë informacioni është marrë ose nuk është marrë.

EKIPI I PROJEKTIT - Rolet e menaxherit të projektit

- ▶ Një nga vendimet më të rëndësishme në menaxhimin e projektit është zgjedhja e një menaxheri të projektit apo udhëheqësi të ekipit.
- ▶ Menaxheri i projektit caktohet zakonisht në fazat më të hershme të ciklit jetësor të projektit, por një njeri i ri mund të sjellët si zëvendësim në fazat e mëvonshme të një projekti.
- ▶ Menaxheri i projektit duhet të luajë shumë role.
- ▶ Së pari, menaxheri i projektit duhet të luajë një rol menaxherial që fokusohet në planifikimin, organizimin, dhe kontrollin.
- ▶ Menaxheri i projektit duhet gjithashtu të kryejë shumë funksione administrative, duke përfshirë rishikime të performancës, ndjekja e projektit dhe raportimi, dhe përgjegjësi të tjera ditore të përgjithshme.
- ▶ Menaxheri i projektit duhet të dinë se kur do të përshtas ose ndryshojë planin e projektit duke përshpejtuar aktivitete të caktuara ose duke vepruar si një zgjidhës i problemeve.

EKIPI I PROJEKTIT - Rolet e menaxherit të projektit - (2)

- ▶ Disa attribute për një menaxheri të suksesshëm të projektit përfshijnë:
 - ▶ Aftësia për të komunikuar me njerëz,
 - ▶ Aftësia për t'u marrë me njerëz,
 - ▶ Aftësia për të krijuar dhe mbajtur marrëdhëniet,
 - ▶ Aftësia për të organizuar

EKIPI I PROJEKTIT - Përzgjedhja e ekipit

- ▶ Një tjetër detyrë e rëndësishme e një menaxheri të projektit është përzgjedhja e stafit të projektit.
- ▶ Përzgjedhja e njerëzve të duhur mix, me të dy aftësitë teknike dhe jo teknike, është një vendim që mund të ndikojë në rezultatin e projektit.
- ▶ Pjesëtarët e ekipit të projektit duhet të zgjidhet bazuar në aftësitë e mëposhtme:
 - ▶ Aftësitë teknologjike,
 - ▶ Aftësi biznesi / organizimi,
 - ▶ Shkathtësitë ndërpersonale.
- ▶ Është e rëndësishme që performanca e ekipit të jetë shqetësim i madh për menaxherin e projektit, andaj menaxheri i projektit duhet të kujdeset për performancën e ekipit të tijë.

EKIPI I PROJEKTIT - Ekipi I projektit dhe menaxhimi I njohurive

- ▶ Sfida kryesore e ekipeve të vërteta është për të zhvilluar performancë të përbashkët për një qëllim të përbashkët.
- ▶ John Redding (2000) në librin *The Radical Team Handbook*, përshkruan një formë krejtësisht të re dhe të ndryshme të punës si ekip të bazuar në të mësuarit.
- ▶ Bazuar në një studim të 20 ekipeve, Redding sugjeron se ekipet tradicionale priren për të:
 - ▶ Pranuar informata me vlerë nominale,
 - ▶ Qasja në projekte në mënyrë lineare.
- ▶ Në të kundërt, Redding përshkruan një ekip radikal si një ekip që është në gjendje për tu marrë në rrënjë më çështjen apo fundamentin.
- ▶ Redding (2000) sugjeron se një cikël të mësuarit në ekip ka katër faza:

EKIPI I PROJEKTIT - Ekipi I projektit dhe menaxhimi I njohurive

Learning Cycles and Lessons Learned




Figure 4.6 A Learning Cycle

MJEDISI I PROJEKTIT

- ▶ Përveç marrjes më burimet njerëzore, menaxheri i projektit duhet të fokusohet gjithashtu në mjedisin e projektit.
- ▶ Mjedisi i projektit përfshin:
 - ▶ Një vend për të thirrur në shtëpi,
 - ▶ Teknologjinë,
 - ▶ Furnizimet e zyrës,
 - ▶ Kulturën

RESURSET NJERËZORE GJATË PROCESIT TË MENAXHIMIT TË PROJEKTIT

► **PYETJE PËR KËTË KAPITULL?**